# DËSHMI ARKIVI

**A-442874**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hoxha: Procesi në Hagë na bëri të reflektojmë për trajtimin e luftës së UÇK-së pas çlirimit |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/hoxha-procesi-ne-hage-na-beri-te-reflektojme-per-trajtimin-e-luftes-se-uck-se-pas-clirimit/1010759/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 11:23:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:20:34 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7adab4a54b7dffb85d16c61b2824f718d8273d0fa2fe81092fbbe1b35a0ba312` |
| TEKSTI | `46102a9a929842b711014936b0e3d38ed93e8c559bd702284da690b1f548a9bc` |
| PAMJA | `140652492b500b22f7c23ca29ce0bd31118216d3eda101edb992fca5a67ce6b5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dc2e7427890bfa956ca613ccb043aeb207bc5313b48e332b5f31b26a202f30fe` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dc2e7427890bfa956ca613ccb043aeb207bc5313b48e332b5f31b26a202f30fe`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Hoxha: Procesi në Hagë na bëri të reflektojmë për trajtimin e luftës së UÇK-së pas çlirimit




Konteksti i krijuar nga Dhomat e Specializuara në Hagë ka rikthyer vëmendjen te mënyra se si është trajtuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës pas përfundimit të luftës. Këtë vlerësim e bëri Eliza Hoxha gjatë hapjes së konferencës kombëtare "Lufta për UÇK-në", organizuar nga platforma "Liria ka emër".

Sipas Hoxhës, përveç goditjes dhe cenimit të figurave të ndryshme të UÇK-së, shoqëria dhe institucionet nuk kanë bërë sa duhet për të ruajtur, dokumentuar dhe përcjellë historinë e saj.

Ajo e cilësoi situatën aktuale si një periudhë kritike e historike për Kosovën, por njëkohësisht edhe si një moment të ndjeshëm për shtetin dhe shoqërinë.

Hoxha: Nuk kemi bërë mjaftueshëm për ta ruajtur në kujtesë luftën e UÇK-së

Eliza Hoxha tha se titulli i konferencës, "Lufta për UÇK-në", mbart një ironi, pasi procesi i zhvilluar në Hagë duket se i ka shtyrë kosovarët të reflektojnë mbi mënyrën se si e kanë trajtuar luftën pas çlirimit.

Ajo ngriti pyetje për atë që është bërë për dokumentimin e luftës, përfshirjen e saj në edukimin e vazhdueshëm të fëmijëve dhe brezave të rinj, si dhe për pasqyrimin e saj në muze e në botime që do të trajtonin betejat, luftëtarët e rënë dhe ata që vazhdojnë të jenë aktivë në jetën publike.

Hoxha kritikoi gjithashtu gjykimet publike ndaj figurave të ndryshme, duke thënë se, përtej denigrimit dhe njollosjes së disa personazheve për shkak të qëndrimeve personale ndaj aktorëve të caktuar, nuk është bërë diçka tjetër dinjitoze për trajtimin e kësaj historie.

Ajo theksoi se ky moment është i rëndësishëm dhe i ndjeshëm si për ish-pjesëtarët që, sipas saj, po mbahen padrejtësisht prej tash e gjashtë vjetësh në Hagë, ashtu edhe për Kosovën si shoqëri dhe shtet.

Profesori Enver Hasani shprehu bindjen se Kosova do ta përballojë edhe këtë proces dhe do të dalë

të fundit/


Deklarata e Isa Mustafës për "diktaturë" ndez debatin: Analist…


Berisha: Ron Yeffet varianti jo shqiptar i Ergys Agasit, por…


Rolando Maran rrëfen jetën në Shqipëri: Nga "avash-avash" te tavë…


Berisha pas kthimit nga SHBA: Edhe pas 35 vitesh u paraqita si…


VIDEO/ Publikohen pamjet nga dhuna e policisë ndaj…


Ambasada amerikane njofton për protesta në Kosovë para vendimit…


Prokuroria: Thaçi synoi të drejtonte dëshminë e Zyrapit, jo thjesht ta…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Profesori Enver Hasani shprehu bindjen se Kosova do ta përballojë edhe këtë proces dhe do të dalë "faqebardhë" nga ajo që e quajti "stuhia e fundit".

Hasani tha se Kosova, si shtet i ri dhe fragjil, është përballur me vështirësi të shumta si para, ashtu edhe pas shpalljes së pavarësisë.

Hasani: Kosova do ta përballojë edhe këtë stuhi dhe do të dalë faqebardhë

Ai u shpreh optimist se Kosova do të dalë faqebardhë si në aspektin politik, ashtu edhe në atë juridik. Sipas Hasanit, që nga periudha pasluftës, para pavarësisë dhe pas shpalljes së saj, vendi është përballur me procese të njëpasnjëshme dhe probleme të llojeve të ndryshme, të vështira për t'u përballuar nga një popull dhe shtet kaq i vogël e fragjil.

Megjithatë, ai beson se Kosova do ta kalojë edhe këtë stuhi të fundit dhe do të dalë faqebardhë.

Diplomati Ylber Hysaj e përshkroi projektin "Liria ka emër" si një përpjekje për t'iu kundërvënë harresës.

Gjatë fjalës së tij, Hysaj kujtoi edhe vitet nëntëdhjetë, kur kishte shkruar për ekzistencën e UÇK-së dhe reagimet që kishte marrë për këtë qëndrim.

Hysaj: "Liria ka emër" përfaqëson luftën kundër mallkimit të harresës

Hysaj tregoi se, kur në vitet e 90-ta kishte shkruar se UÇK-ja ekzistonte, një person i rëndësishëm nga bota e gazetarisë i kishte thënë, gjysmë me shaka dhe gjysmë seriozisht: "Ti ose je spiun ose budallë". Ai vlerësoi se, parë nga perspektiva e sotme, kjo shprehje duket cinike dhe e rëndë, por në atë kohë kishte qenë një reagim njerëzor.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, tha se pas shpalljes së pavarësisë Kosova është përballur me një tjetër betejë politike dhe juridike, të lidhur me proceset në Dhomat e Specializuara.

Hoxhaj shprehu optimizëm se ish-krerët e UÇK-së që po gjykohen në Hagë do të lirohen dhe do të kthehen në Kosovë.

Sipas tij, lufta e UÇK-së ishte e veçantë edhe sepse kishte mbështetjen dhe "certifikimin" e NATO-s.

Hoxhaj: Lufta e UÇK-së ishte e certifikuar nga NATO

Hoxhaj deklaroi se nuk ka pasur në Evropë apo në botë një luftë tjetër të certifikuar nga NATO, duke iu referuar luftës së UÇK-së. Ai shtoi se edhe pavarësia e Kosovës ishte rezultat i një procesi të bazuar në konceptin e sovranitetit dhe të një pavarësie të merituar, pas përmbushjes së shumë kushteve dhe kritereve nga populli i Kosovës.

Shtuar më 14.09.2026 13:20

Tags: Eliza Hoxha , liri , Speciale



Deklarata e Isa Mustafës për "diktaturë" ndez debatin: Analistët mbrojn…




Ambasada amerikane njofton për protesta në Kosovë para vendimit për…



Prokuroria: Thaçi synoi të drejtonte dëshminë e Zyrapit, jo thjesht ta…



Valon Prebreza shkarkon drejtorin e Pronës pas arrestimit të tij



Tre gjyqtarët që do të vendosin për Thaçin, Veselin, Selimin dhe…



Nagip Krasniqi mohon sërish akuzën për keqpërdorim të detyrës…



Zbulohet paneli i gjyqtarëve që do të shpallë vendimin për ish-udhëheqësit e…




SHBA paralajmëron për tubime masive në Kosovë në prag të vendimit për is…




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.